

Vendim nr. 76, datë 18.06.2026

(V- 76/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Marjana Semini, Ilir Toska, Genti Ibrahim, anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 18.06.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen Nr. 4 (J) 2025 i Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **JAK DOBROZI, MANUSHE DOBROZI, EGLANTINA LLESHI (DOBROZI), GËZIM DOBROZI, ILIR DOBROZI,**
përfaqësuar nga avokati Edmond Bunaj, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

GJOVALIN MENGA, përfaqësuar nga avokati Ali Paja, me prokurë.

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, DREJTORIA VENDORE LEZHË

AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS, DREJTORIA VENDORE KURBIN

AVOKATURA E SHTETIT, përfaqësuar nga Denisa Skënderaj.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2024-3680 (388), datë 25.09.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi i çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore në Gjykatën e Lartë, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: **Nenet 15, 16, 42, 43, 124, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta); nenet 1 dhe 6, paragrafi 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), si dhe neni 1 i**

Protokollit nr. 1 të saj ; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji Organik i Gjykatës).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjo i relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuësve Jak Dobrozi, Manushe Dobrozi, Eglantina Lleshi (Dobrozi), Gëzim Dobrozi, Ilir Dobrozi, (*kërkuësit*), të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Gjovalin Mengës dhe Avokaturës së Shtetit, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në vitin 1996, në zbatim të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën” (*ligji nr. 7501/1991*), kërkuësi Jak Dobrozi, si kryefamiljar i familjes bujqësore, është trajtuar me 10.000 metra katrorë tokë, të llojit “arë”, nga Komisioni i Ndarjes së Tokës të fshatit Gjorm me Aktin e Marrjes së Tokës në Pronësi nr. 453 (*AMTP nr. 453*). Me kërkesën e subjektit të interesuar, Gjovalin Mengës, në zbatim të ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” (*ligji nr. 9948/2008*), Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore (*Komisioni Vendor*) pranë prefektit të qarkut Lezhë ka verifikuar vlefshmërinë e këtij titulli pronësie dhe, pas hetimit administrativ, e ka shfuqizuar atë me vendimin nr. 122, datë 05.05.2014.

2. Në vijim të vendimit të Komisionit Vendor, prefekti i qarkut Lezhë i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, me vendimin nr. 5472, datë 07.10.2014, ka vendosur shfuqizimin tërësisht të AMTP-së nr. 453 dhe kthimin e tokës në pronësi të shtetit. Ajo gjykatë ka arsyetuar se kërkuësi nuk mund të përfitonte tokë bujqësore në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore të zbatueshme.

3. Në bazë të ankimit të kërkuësit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 934, datë 02.03.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë, duke konfirmuar se krijimi i AMTP-së nr. 453 është bërë në përputhje me kërkesat

e VKM-së nr. 255, datë 02.08.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs subjektet e interesuara Gjovalin Menga, Avokatura e Shtetit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK). Në datën 20.03.2018, përpara shqyrtimit të rekursit, subjekti i interesuar Gjovalin Menga ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për heqjen dorë nga rekursi, e cila është pranuar.

4. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-3680 (388), datë 25.09.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Ajo gjykatë ka arritur në përfundimin se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit material mbi rrethanat konkrete të çështjes në gjykim.

5. Në datën 28.08.2025 (sipas shërbimit postar), kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili është regjistruar në datën 29.08.2025. Në fazën e shqyrtimit paraprak të çështjes, Mbledhja e Gjyqtarëve, me vendimin e datës 26.01.2026, ka pranuar dorëheqjen e njërit prej gjyqtarëve në përbërje të Kolegjit. Në vijim të kësaj procedure, në datën 04.02.2026, Kolegji ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. **Kërkuesit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se vendimet e kundërshtuara i kanë cenuar *të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, në drejtim të:

6.1. *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme*, pasi Gjykata e Lartë, duke mbajtur dy standarde në lidhje me të drejtën e njoftimit të palëve në gjykim (janë njoftuar vetëm paditësit), ka bërë që kjo gjykatë të mos japë garanci të mjaftueshme procedurale për të shmangur çdo dyshim të arsyeshëm për paanshmërinë e saj.

6.2. *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë parasysh asnjë nga pretendimet e parashtruara nga kërkuesit, duke lejuar të prevalojnë argumentet e palës rekursuese.

6.3. *Së drejtës për t’u njoftuar të lidhur me të drejtën për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka kryer shpalljen për njoftimin e datës dhe të orës së seancës

në dhomën e këshillimit, ndërsa ka njoftuar për seancën vetëm palën paditëse, si dhe nuk ka njoftuar kërkuesin (të paditurin) për kalimin procedural të palës paditëse. Relacioni i gjyqtarit për shqyrtimin paraprak të çështjes nga Gjykata e Lartë nuk përmban datë ose të dhëna nëse u është shpërndarë edhe anëtarëve të tjerë të trupit gjykues, ndërkohë që gjykimi i çështjes vlerësohet të jetë kryer në një hapësirë kohore prej 10 minutash. Po kështu, referimi i Gjykatës së Lartë në jurisprudencën e saj, pa cituar vendimmarrje konkrete, i ka cenuar të drejtën për të debatuar për këto vendime, për rrjedhojë për t'u dëgjuar.

6.4. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë në asnjë moment nuk ka hetuar çështjen, por gjatë gjithë gjykimit në dhomën e këshillimit (10 minuta seancë) ka relatuar vetëm kërkimet e palës paditëse, si dhe nuk ka shqyrtuar kërkimet dhe pretendimet e palës së paditur, dhe as shkaqet për të cilat gjykata e apelit ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Gjykata e Lartë duhet të kishte pushuar gjykimin, pasi ai nuk duhet të vazhdonte në bazë të nenit 68, paragrafi 5, të ligjit 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 20/2020), ku parashikohet qartë se ASHK-ja duhet të heqë dorë nga të gjitha gjykimet në proces të vëna në lëvizje nga paditë e ngritura nga prefektët përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me objekt pavlefshmërinë ose shfuqizimin e AMTP-ve.

7. Subjekti i interesuar, Gjovalin Menga, ka prapësuar si vijon:

7.1. Vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë është i bazuar në ligj dhe në provat e administruara dhe procesi gjyqësor i zhvilluar në atë gjykatë ka respektuar garancitë procedurale. Kërkuesit kanë pasur mundësi efektive për të marrë dijeni për rekursin dhe për seancën, si dhe për të ushtruar të drejtat e tyre procedurale gjatë të gjitha fazave të procesit gjyqësor dhe administrativ. Njoftimi për gjykimin është kryer me shpallje e konkretisht në datën 26.07.2024, një mjet ky i parashikuar në nenin 133/b të Kodit të Procedurës Civile (KPC). Vetë pala duhet të ishte interesuar. Ajo nuk ka paraqitur kundërrekurs dhe as nuk ka treguar interes për të marrë informacion në Gjykatën e Lartë. Vendimi i kësaj gjykatë është i mirargumentuar e në zbatim të plotë të ligjit material, ndërsa vendimi i gjykatës së apelit ka qenë me shkelje të rënda të ligjit material.

7.2. Kërkuesit synojnë të legjitimojnë një titull pronësie të fituar në kundërshtim me legjislacionin për ndarjen e tokës bujqësore, pasi ata nuk kanë qenë subjekte përfituese

sipas ligjit nr. 7501/1991 dhe akteve nënligjore, për arsye se nuk ka qenë as punonjëse, as banorë, as themelues, as specialistë dhe as të persekutuar politikë në datën 01.08.1991 në ndërmarrjen bujqësore Gjorm. Siç ka rezultuar e provuar, kërkuesi Jak Dobrozi ka qenë themelues në kooperativën bujqësore Gramëz, Thumanë, e cila është ndarë nga fshati Gjorm që në vitin 1976. Edhe pretendimi se kërkuesi posedon qetësisht dhe pa ndërprerje tokën objekt mosmarrëveshjeje nuk është i vërtetë, pasi në fakt subjekti i interesuar e ka poseduar e shfrytëzuar atë që prej vitit 1993.

8. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar si vijon:

8.1. *Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi Gjykata e Lartë ka njoftuar për seancën në dhomën e këshillimit vetëm palën paditëse dhe jo kërkuesit, nuk është ngritur në nivel kushtetues, pasi nuk janë parashtruar argumente të mjaftueshme për të provuar cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme, në kuptim të testit subjektiv dhe testit objektiv të vlerësimit kushtetues të këtij parimi. Si rrjedhim, Gjykata nuk duhet ta marrë në shqyrtim këtë pretendim.

8.2. *Për pretendimin për cenimin e së drejtës për njoftim*, nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë dhe nga aktet e dosjes gjyqësore, rezulton se sekretaria gjyqësore e asaj gjykate ka njoftuar me shpallje datën dhe orën e seancës në dhomën e këshillimit, të paktën 30 ditë përpara zhvillimit të saj. Është pala kërkuese ajo që ka pasur detyrimin për të kryer verifikime në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, për efekt të marrjes dijeni të datës së seancës në dhomën e këshillimit, për sa kohë që ka qenë në dijeni të procesit gjyqësor në këtë gjykatë. Si rrjedhim, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar është i papabazuar dhe, si i tillë, duhet të rrëzohet.

8.3. *Për pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar*, në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se kjo e drejtë nuk nënkupton vetëm atë për t'u paraqitur personalisht përpara organit të pushtetit publik, por ajo realizohet edhe përmes shqyrtimit të dokumenteve, nëpërmjet komenteve dhe shpjegimeve të dhëna me shkrim. Në këtë mënyrë, ky pretendim nuk përmban argumente të mjaftueshme nga pikëpamja kushtetuese për të provuar cenimin e kësaj të drejte dhe, si i tillë, nuk duhet marrë në shqyrtim nga Gjykata. Për më tepër, asnjë prej argumenteve të parashtruara nuk ka lidhje me cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar, por një pjesë e tyre ka lidhje me të drejtën për t'u njoftuar për të cilën subjekti i interesuar ka dhënë prapësimet e tij për sa më sipër.

8.4. *Për pretendimet për cenimin e parimit për hetim të plotë dhe të gjithanshëm* kërkuesit kanë pretenduar se Gjkata e Lartë në asnjë moment nuk ka hetuar çështjen, kërkimet dhe pretendimet e palës së paditur, por gjatë gjithë gjykimit në dhomën e këshillimit (10 minuta seancë), ka relatuar vetëm kërkimet e palës paditëse. Ky pretendim nuk është ngritur në nivel kushtetues dhe, si i tillë, duhet të mos merret në shqyrtim nga Gjkata.

8.5. *Lidhur me pretendimin për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* argumente e parashtruara nuk përbëjnë objekt për t'u marrë në shqyrtim nga Gjkata, pasi, në thelb, ato nuk paraqesin një cenim të natyrës kushtetuese, por kanë të bëjnë me mënyrën e shqyrtimit dhe të vlerësimit të provave, si dhe interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme. Në çështjen konkrete, arsytimi i gjykatave plotëson kriteret e vendosura në jurisprudencën e Gjykatës, për rrjedhojë pretendimi i kërkuesve është i pabazuar. Vendimi i kundërshtuar tregon vendimmarrjen, shkaqet e ngritura në rekurs, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku mbështetet qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Gjkata e Lartë, brenda kompetencave të saj si gjkatë ligji, ka kontrolluar ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të faktit për interpretimin e ligjit material prej tyre në garantim të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Për më tepër, pretendimi, në thelb, ka të bëjë me vlerësimin e provave dhe interpretimin dhe zbatimin e ligjit, që është çështje tej juridiksionit të Gjykatës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. *Për legjitimitimin e kërkuesve*

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar

në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në këtë këndvështrim, kërkesit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj justifikojnë interesin në çështjen e parashtruar. Po kështu, ato plotësojnë edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, pasi kanë shteruar në formë e në substancë mjetet e zakonshme të ankimit, për rrjedhojë nuk kanë mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

11. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se, në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare, ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë drejtim, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka pohuar se i takon, në radhë të parë, Gjykatës së Lartë të sigurojë që në dosjen e çështjes së saj të ketë prova për datën e dorëzimit të vendimit palëve (*shih Ibrahim dhe të tjerë k. Shqipërisë, datë 14.01.2025, § 13*).

12. Në çështjen në shqyrtim, Gjykata vëren se vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është i datës 25.09.2024, ndërsa kërkesa për kontrollin kushtetues të vendimit gjyqësor është paraqitur në datën 29.08.2025. Kërkesit kanë parashtruar se janë njohur me vendimin në datën 27.05.2025 në rrugë jozyrtare, pasi në zyrën e ASHK-së, Drejtoria Vendore Lezhë, ka mbërritur vendimi i Gjykatës së Lartë, i cili ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Pasi janë njohur me këtë fakt, kërkesit i janë drejtuar Gjykatës së Lartë në datën 30.05.2025 për t’u njohur me vendimin dhe me dosjen me aktet procedurale. Në dosjen gjyqësore të administruar për efekt të këtij gjykimi kushtetues, nuk rezultojnë prova/dokumente që të vërtetojnë datën e dorëzimit të vendimit të Gjykatës së Lartë kërkesve. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se kërkesit legjitimohen edhe *ratione temporis*.

13. Për sa i takon legjitimitetin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkesit kanë pretenduar se u janë cenuar: (i) e drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, për shkak të standardit të dyfishtë të Gjykatës së Lartë në njoftimin e palëve; (ii) *parimi i barazisë së armëve*

dhe i kontradiktoritetit, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka marrë parasysh argumentet e parashtruara nga kërkuesit; (iii) *e drejta për t'u njoftuar* e lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka njoftuar për zhvillimin e seancës dhe për kalimin procedural të palës paditëse; (iv) *standardi i arsyetimit* të vendimit, pasi Gjykata e Lartë nuk ka bërë një hetim të plotë të çështjes dhe ka gabuar në identifikimin e ligjit të zbatueshëm.

14. Për sa i përket pretendimit për cenim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, Gjykata vëren se argumentet në themel të tij kanë të bëjnë me të drejtën për t'u njoftuar dhe, për pasojë, do të trajtohen në kuadër të pretendimeve lidhur me këtë të drejtë. Për sa u takon pretendimeve për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, Gjykata vëren se, duke pasur parasysh se procesi gjyqësor kushtetues është i natyrës argumentuese, argumentet e kërkuesit në lidhje me këtë pretendim nuk janë të mjaftueshme për të identifikuar çështjen kushtetuese dhe, si të tilla, nuk mund të bëhen objekt i kontrollit nga Gjykata.

15. Lidhur me pretendimet për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar, të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur (shih paragrafët 6.3 dhe 13 të vendimit), subjekti i interesuar, Gjovalin Menga ka prapësuar se kërkuesit kanë pasur mundësi efektive për të marrë dijeni për procesin. Ndërsa subjekti i interesuar ASH ka prapësuar se e drejta për njoftim nuk është cenuar, pasi data dhe ora e seancës në dhomën e këshillimit janë publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë brenda afatit ligjor (shih paragrafin 8.2 të vendimit).

16. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta për t'u njoftuar dhe për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për procesin gjyqësor, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Në këtë kuptim, kjo e drejtë, ndër të tjera, i krijon një pale ndërgjyqëse të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (shih vendimet nr. 40, datë 14.09.2023; nr. 8, datë 23.02.2021; nr. 49, datë 22.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata është shprehur, gjithashtu, se është detyrë e administratës gjyqësore të marrë masat për të kryer njoftimin e palëve ndërgjyqëse (shih vendimet nr. 41, datë 29.05.2024; nr. 47, datë 06.07.2015; nr. 32, datë 22.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese).

17. Gjykata vëren se neni 61 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar ka parashikuar se shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve në dhomën

e këshillimit. Gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton, me shpallje, ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues, të paktën 15 ditë përpara. Në shtesë të këtyre rregullave, neni 482, pika 3, i KPC-së, i zbatueshëm edhe për gjykimin administrativ, parashikon se njoftimi me shpallje bëhet edhe në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë. Krahas njoftimit me shpallje, kjo dispozitë parashikon edhe njoftimin individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjyqimit.

18. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje mbi bazën e rekursit të subjektit të interesuar Gjovalin Menga, Avokaturës së Shtetit dhe ASHK-së. Nga materialet në dosjen gjyqësore të administruar për nevoja të këtij gjykimi kushtetues, konstatohet se kërkuesit kanë marrë dijeni për këto rekurse me anë të dëftesave respektive të komunikimit të datës 31.05.2017, për rekursin e paraqitur nga subjekti i interesuar Gjovalin Menga dhe të datës 26.04.2017, për rekursin e paraqitura nga Avokatura e Shtetit dhe ASHK-ja, por nuk kanë paraqitur kundërrekurs. Më tej, Gjykata vëren se sipas të dhënave të faqes zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë konstatohet se në datën 26.07.2024 është publikuar lista e çështjeve që do të gjykoreshin në dhomën e këshillimit të datës 25.09.2024, ku përfshihej edhe çështja e kërkuesve. Gjithashtu, nga dosja gjyqësore nuk rezulton që kërkuesi të ketë bërë me dije për Gjykatën e Lartë të dhënat elektronike të kontaktit e as që këto të dhëna të jenë depozituar në shkallët e mëparshme të gjyqimit. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se në ndryshim nga sa pretendojnë kërkuesit, pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar të lidhur me të drejtën për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur është haptazi i pabazuar.

19. Kërkuesit kanë pretenduar gjithashtu se vendimi i Gjykatës së Lartë ka cenuar *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor*, duke parashtruar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka bërë një hetim të plotë të çështjes dhe ka gabuar në identifikimin e ligjit të zbatueshëm. Duke mbajtur në konsideratë natyrën kushtetuese të këtij pretendimi, Gjykata çmon ta analizojë atë në themel në dritën e garancive të parashikuara nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

20. Kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë, në bazë të nenit 14 të KPC-së, ka për detyrë të zhvillojë një proces të rregullt ligjor nëpërmjet garantimit të zhvillimit të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në përputhje me ligjin. Ajo gjykatë në asnjë moment nuk ka hetuar çështjen, por gjatë gjithë gjykimit në dhomën e këshillimit ka relatuar vetëm kërkimet e palës paditëse, si dhe nuk ka shqyrtuar kërkimet dhe pretendimet e palës së paditur dhe as shkaqet për të cilat gjykata e apelit ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, të cilat konfirmojnë faktin e krijimit të AMTP-së nr. 453 në përputhje me kërkesat e VKM-së nr. 255 datë 02.08.1991. Gjithashtu, kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata e Lartë duhet të kishte pushuar gjykimin, pasi ai nuk duhet të vazhdonte në bazë të nenit 68, paragrafi 5, të ligjit nr. 20/2020, ku parashikohet qartë se ASHK-ja duhet të heqë dorë nga të gjitha gjykimet në proces të vëna në lëvizje nga paditë e ngritura nga prefektët para hyrjes në fuqi të këtij ligji me objekt pavlefshmërinë ose shfuqizimin e AMTP-ve.

21. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shteti, ka prapësuar se vendimi i Gjykatës së Lartë nuk ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Pretendimet e palës kërkuese nuk përbëjnë objekt për t'u marrë në shqyrtim nga Gjykata, pasi, në thelb, ato nuk paraqesin një cenim të natyrës kushtetuese, por kanë të bëjnë me mënyrën e shqyrtimit dhe vlerësimit të provave dhe interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme. Gjykata e Lartë, brenda kompetencave të saj si gjykatë ligji, ka kontrolluar ligjshmërinë e vendimmarrjes së gjykatave të faktit për interpretimin e ligjit material prej tyre në garantim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Ndërsa subjekti i interesuar Gjovalin Menga, në lidhje me këtë pretendim të kërkuesit, ka prapësuar se vendimi i kësaj gjykatë është i mirargumentuar e në zbatim të plotë të ligjit material, ndërsa vendimi i gjykatës së apelit me shkelje të rënda të ligjit material.

22. Sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 67, datë 10.11.2017; nr. 21, datë 16.04.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Ky detyrim nuk mund të interpretohet sikur kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palës ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 35, datë 25.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithsesi, zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes dhe natyrës së vendimit, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të

mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit interpretimi i ligjit material e procedural, zbatimi i tij në çështjet konkrete, çmuarja e provave, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes të të drejtave kushtetuese të individit për proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit, si dhe të çmuarjes së provave për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 4, datë 21.02.2022; nr. 45, datë 23.07.2012; nr. 31, datë 05.07.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Mbi bazën e standardeve të mësipërme, Gjykata, në vijim, do të verifikojë nëse Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje kërtimeve dhe pretendimeve të palës së paditur dhe nëse ka marrë në shqyrtim shkaqet për të cilat gjykata e apelit ka vendosur rrëzimin e padisë së prefektit. Po kështu, Gjykata do të verifikojë nëse Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka kryer verifikimet e nevojshme për ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi, duke garantuar kështu parimin kushtetues të arsyetimit të vendimit gjyqësor.

25. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, brenda kompetencës funksionale të tij, ka kryer një vlerësim ligjor mbi faktet e përcaktuara nga gjykatat e faktit dhe ka vlerësuar se analiza e bërë prej gjykatës të shkallës së parë është e mbështetur në zbatimin korrekt të ligjit, ndërsa vlerësimi ligjor i gjykatës së apelit është i gabuar dhe për këtë arsye duhet të priset dhe të lihet në fuqi disponimi i gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se analiza e gjykatës së apelit është mbështetur në evidentimin e pasaktësive materiale në vendimin e Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë, pranë Prefektit të Qarkut Lezhë, pa u ndalur në analizën ligjore të shkaqeve për të cilat prefekti i qarkut Lezhë ka kërkuar deklarin e pavlefshmërisë së AMTP-së nr. 453.

26. Gjykata e Lartë e ka gjetur të përligjur interpretimin ligjor të gjykatës së shkallës së parë se për të përfitur tokë bujqësore duhet që subjekti të këtë qenë anëtar i kooperativës bujqësore dhe banor i saj ose qoftë dhe vetëm banor i fshatit sipas gjendjes civile në datën 01.08.1991, si dhe konstatimin prej saj të faktit se kërkuesi Jak Dobrozi nuk ka qenë anëtar i NB-së Gjorm dhe as banor i këtij fshati në datën 01.08.1991, por banor i lagjes nr. 6, qyteti Laç (në atë kohë i quajtur

fshati Laç). Për pasojë, Gjykata vlerëson se ky komponent i pretendimit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

27. Në lidhje me pretendimin se Gjykata e Lartë duhet të kishte pushuar gjykimin, pasi ai nuk duhet të vazhdonte në bazë të nenit 68 i ligjit nr. 20/2020, duhet theksuar se Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje prej rekursit të bërë nga ana e subjektit të interesuar Gjovalin Menga, Avokaturës së Shtetit dhe ASHK-së (duke zëvendësuar në gjykim prefektin e qarkut Lezhë), në vitin 2017, pra para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 20/2020.

28. Lidhur me AMTP-të dhe verifikimin e titujve, vërehet se ligji nr. 20/2020, i cili ka hyrë në fuqi pas vendimit të gjykatës së apelit (viti 2017), në dispozitat kalimtare të tij parashikon se paditë e ngritura nga prefektët para hyrjes në fuqi të atij ligji, me objekt pavlefshmërinë/shfuqizimin e AMTP-ve, shqyrtohen nga gjykatat, sipas kriterëve të atij ligji dhe se ASHK-ja (si pasardhëse ligjore e prefektit) heq dorë nga padia në të gjitha gjykimet në proces përpara hyrjes në fuqi të ligjit, përveç rasteve kur shkak i padisë është sipas përcaktimeve të nenit 7, pika 1, të atij ligji (neni 68, pikat 4 dhe 5). Ndërsa neni 7, pika 1, i ligjit parashikon se AMTP-ja e përfituar përpara hyrjes në fuqi të atij ligji, e paregjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, nuk i nënshtrohet verifikimit të vlefshmërisë nga ASHK-ja. Ajo regjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme nëse plotësohen njëkohësisht kriteret e mëposhtme: a) përfituesi i AMTP-së ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore ose, edhe nëse nuk ka qenë i legjitimuar, ka përfituar tokën, për të cilën i është hequr pronësia atij apo trashëgimlënësit gjatë krijimit të ish-kooperativës ose ish-ndërmarrjes bujqësore; b) përfituesi i AMTP-së ka marrë tokë në territorin e vetëm një ish-kooperative ose ish-ndërmarrjeje bujqësore; c) toka për të cilën është lëshuar AMTP-ja nuk ka qenë “trual”, “vepër e infrastrukturës publike”, “rërë bregdetare”, “plazh” ose “sipërfaqe ujore”, në kohën e lëshimit të aktit.

29. Gjykata konstaton se rekursi ndaj vendimit të gjykatës së apelit janë ngritur përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 20/2020 në datën 07.05.2020. Për sa i përket rekursit të subjektit të interesuar Gjovalin Menga, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë ka disponuar me mospranimin e tij, për shkak se ai subjekt ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga rekursi. Në këtë mënyrë, gjykimi në Gjykatën e Lartë ka vijuar vetëm në bazë të rekursit të ASHK-së, si pasardhëse ligjore e prefektit dhe Avokaturës së Shtetit.

30. Në lidhje me rekursin e paraqitur nga ASHK-ja, e cila ka zëvendësuar në gjykim prefektin e qarkut Lezhë dhe Avokaturën e Shtetit, Gjykata vëren se mbi ta veprojnë dispozitat

kalimtare, neni 68, pikat 4 dhe 5, i ligjit nr. 20/2020. Në zbatim të këtyre dispozitave, ASHK-ja, si pasardhëse ligjore e prefektit gëzon legjitim aktiv vetëm për rastet kur shkaqet e padisë përputhen me kriteret materiale të nenit 7, pika 1, shkronja “c”.

31. Po në këtë drejtim, Gjykata sjell në vëmendje se në datën 23.07.2024, pra rreth 2 muaj para marrjes së vendimit të kundërshtuar, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka marrë vendimin e ndërmjetëm për njësimin e praktikës gjyqësore në këtë fushë. Më tej, në datën 18.02.2025, disa muaj pas vendimmarrjes për kërkuesit, Gjykata e Lartë ka nxjerrë vendimin nr. 00-2025-4083 (79), në të cilin ka arritur në këtë rregull njësues: i) në zbatim të nenit 68, pika 5, të ligjit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë për të gjitha paditë e ngritura nga prefekti, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji me objekt pavlefshmërinë/shfuqizimin e AMTP-ve, pavarësisht se në cilën shkallë gjykimi ndodhen, ASHK-ja detyrohet të heqë dorë nga e drejta e padisë, përveç rasteve kur shkaku ligjor i padisë është sipas përcaktimeve të nenit 7, pika 1, të atij ligji; ii) kur mungon vullneti i shprehur për heqjen dorë nga e drejta e padisë prej ASHK-së, në zbatim të nenit 68, pika 4, të ligjit për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë, gjykatat vijnë shqyrtimin e padive të ngritura nga prefektët me objekt pavlefshmërinë/shfuqizimin e AMTP-ve, sipas kriterëve të atij ligji; iii) në rast se në padi ngrihen formalisht pretendime me shkaqe nga ato të përcaktuara nga neni 7, pika 1, i ligjit, gjykatat disponojnë për pranimin ose rrëzimin e padisë, varësisht gjendjes së faktit të vërtetuar. Nëse padia nuk ngre formalisht asnjë nga shkaqet e përcaktuara nga neni 7, pika 1, i ligjit, gjykatat vlerësojnë mungesën e legjitimitetit aktiv material të palës paditëse dhe disponojnë me rrëzimin e padisë.

32. Gjithashtu, Gjykata konstaton se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin e kundërshtuar ka theksuar se ligji drejtpërdrejt i zbatueshëm në rastin konkret objekt gjykimi është ai nr. 9948/2008 (*shih vendimin nr. 00-2024-3680 (388), datë 25.09.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, paragrafi 44*). Ky ligj përfshihet në shtojcën e ligjit nr. 20/2020, ku listohen aktet që shfuqizohen.

33. Në këto kushte, Gjykata çmon se Gjykata e Lartë duhej të arsyetonte në mënyrë të posaçme për zbatimin e ligjit nr. 20/2020 dhe veçanërisht në lidhje me mënyrën sesi zbatoheshin dispozitat e këtij ligji për heqjen dorë nga paditë e ngritura nga prefektët para hyrjes në fuqi të tij, me objekt pavlefshmërinë/shfuqizimin e AMTP-ve. Ky detyrim për arsyetim ishte veçanërisht i rëndësishëm, pasi përfundimi mbi ligjin e zbatueshëm për marrëdhënien e kërkuesve dhe detyrimi për heqjen dorë nga e paditë e iniciuara nga prefektët lidheshin drejtpërdrejt me vazhdimin e

çështjes kundër tyre, veçanërisht në kushtet kur subjekti i interesuar ishte tërhequr nga rekursi dhe Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë e kishte pranuar këtë kërkesë.

34. Gjykata konstaton se një arsyetim i tillë nuk rezulton të jetë dhënë. Gjykata e Lartë ka identifikuar ligjin nr. 9948/2008 si ligjin e zbatueshëm dhe nuk ka dhënë një përgjigje në lidhje me vazhdimin e gjykimit pranë kësaj gjykate në kushtet kur ligji nr. 20/2020 kishte përcaktuar se për të gjitha paditë e ngritura nga prefekti, përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji me objekt pavlefshmërinë/shfuqizimin e AMTP-ve, pavarësisht se në cilën shkallë gjykimi ndodhen, ASHK-ja detyrohet të heqë dorë nga e drejta e padisë.

35. Parë në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se vendimi i kundërshtuar nga kërkuesit nuk plotëson mjaftueshëm kriteret e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese për ofrimin e garancive për proces të rregullt ligjor në aspektin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, ndaj pretendimet e tyre për cenimin e këtij komponenti të kërkesës janë të bazuara dhe, për rrjedhojë, vendimi i kundërshtuar i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet dhe çështja duhet të dërgohet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2024-3680(388), datë 25.09.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
3. Kthimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 18.06.2026

Shpallur më 21.07.2026